331	AnM121/3	Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 6.3/7.1 kË, prurja e ajrit Vmax.=1150 m³/h + termostat ambientit	op	8	
332	AnM121/4	Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.1/8.0 kË, prurja e ajrit Vmax.=1150 m³/h + termostat ambientit	op	3	
333	AnM121/5	Montim Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 8.0/9.0 kË, prurja e ajrit Vmax.=1250 m³/h + termostat ambientit	op	1	
334	AnM121/6	Montim Pajisje tip Kanalor me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 5.6 6.3 kË, prurja e ajrit Vmax.= 1000 m³/h + termostat ambientit	op	10	
335	AnM121/7	Montim Pajisje tip Kanalor me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.1 /8.0 kË, prurja e ajrit Vmax.= 1250 m³/h + termostat ambientit	op	21	
336	AnM122	MONTIM NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHITESIE VRF PER KATIN +1	op	2	
337	AnM122/1	Montim NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHITESIE VRF PER KATIN 0°	op	1	
338	AnM122/2	Montim NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHITESIE VRF PER RIKUPERATORET E AJRIT	op	1	
339	AnM122/3	MONTIM NJESI RIKUPERATORE AJRI Volumi i ajrit. 3920 m³/h Presioni statik i jashtem 200 Pa	op	2	
340	AnM121/8	Montim. Kondicioner Mono Split Dysheme - Tavan Kapaciteti në ftohje: 12.1 kË Kapaciteti në ngrohje: 13.1 kË	op	3	
341	AnM121/9	Montim Kondicioner Mono Split Dysheme - Tavan Kapaciteti në ftohje: 2.5 kË Kapaciteti në ngrohje:2.8 kË	op	2	
342	AnM121/10	Montim Ventilator Centrifugal V.air. 16000 m³/h ~ ΔP 200 Pa Fel. 2.2 kË 3F~400V,50Hz	op	1	
343	AnM121/121	Montim Ventilator Centrifugal V.air. 22000 m³/h ~ ΔP400Pa Fel. 5.5 kË 3F~400V,50Hz	op	1	
344	AnM123	Montim Pompa e furnizimit me uje sanitar; Grup i furnizimit me uje sanitar me 2 pompa Vertikale	op	1	
345	AnM124	Montim Autoklavë me membranë - Presioni maximal 6 bar, - Kapaciteti 500 lit	op	0	
346	AnM125	MONTIM POMPE ZHYTESE PER UJRA TE BARDHA - Prurja 9 m³ / h - Prevalenca 12 mkH2O	op	2	
347	AnM126	Montim Ventilator Centrifugal - Prurja 1400 m³/h - Presioni Statik =150 Pa	op	2	
348	AnM127	F.V Elemente montimi dhe mberthimi.(Shirit metalik, gozhde, fasheta)	komplet	1	
349	AnM129	F.V Rakorderi per mberthim tubosh PP-R Ø63 - Ø75	komplet	1	
350	AnM129	F.V Elemente montimi dhe mberthimi. (upa, fasheta, prizhioner, profile metalike, stafa, bulloneri,Upa metalike betoni, gur fresibel, etj)	komplet	1	
351	AnM130	F.V Elemente montimi dhe mberthimi.(upa, fasheta, prizhioner, profile metalike, stafa, bulloneri,Upa metalike betoni)	komplet	1	
352	AnM131	F.V Elemente konstruksioni (upa, fasheta, konstruksione	komplet	1	

		mbajtëse, prizhioner etj)				
353	AnM132	F.V Struktura metalike profile çelik I zi element te salduara, te xinguara ne te nxehte, montim me bulona (per mbeshetjeten - varjen e linjave te tubacioneve etj.)	komplet	1		
354	AnM133	Montim POMPA E IMPIANTIT TE MBROJTJES NGA ZJARRIT - SISTEMI I MNZ-se	komplet	1		
355	AnM134	Montim Hidrant zjarri i jashtem kollone mbi toke DN 80 me dy dalje DN70	komplet	3		
356	AnM135	Elemente Mberthimi - Montim Kasetë jashte murit me kembeze - Dimensionet (370x610x190) mm	komplet	3		
357	AnM136	Elemente Montimi - Kasete + hidrant zjarri i brendshëm	komplet	6		
358	AnM137	Montimi - Grupi i lidhjes me motopompen e zjarrefikeses per hidrant DN 80	komplet	1		
359	AnM138	Montim Fikëse zjarri me CO2 dhe pluhur	komplet	19		
360	AnM139	F. V Elemente mberthimi dhe rakorderi (Bryla, Braga, Reduksion etj)	komplet	1		
361	AnM	F.V. Konstruksione metalike, armatura, profile metalike, Prizhionier Fasheta per kanalet e ajrit.	komplet	1		
362	AnM141	F. V Rakorderi tuba bakri	komplet	1		
363	AnE103	F.V Elektroda tokezimi, Cu fi16 , L=1.5m	ml	8		
364	AnE104	F.V. Percjelles shufer zinku tokezimi, 8mm	ml	836		
365	AnE105	F.V. Percjelles tokezimi bakri , Cu, S=70 mm ² i zhveshur	ml	70		
366	An13	Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 Kafazet e ashensoreve)	m3	33.5		
367	An14	Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m	m3	123		
368	An15	Trare e soletave b/a C30/37 h ~ 4m	m3	150		
369	An16	Soleta te plota b/a C 30/37 t = 15-17 cm	m3	366		
		SHUMA 25:				
		26. PAJISJE JASHTË LISTE				
370	Pj	F.Pompa e furnizimit me uje sanitar; Grup i furnizimit me uje sanitar me 2 pompa Vertikale me Shume shkalle me motor On/Off, te lidhura ne paralel; me panel komandimi dhe presostate per 2 pompa per funksionim automatik. Prurja= 10.0 m ³ /h (per secilen pompe); H =50 m; 3x400V;P= 2 x 4 kË; Lidhjet: 2";	copë	1		
371	Pj	Autoklavë me membranë; presioni maksimal 6 bar; kapaciteti 500 lit	copë	1		
372	Pj	F. POMPE ZHYTESE PER UJRA TE BARDHA; Prurja : 9 m ³ / h; Prevalenca : 12 mkH2O; Tubi i shkarkimit : DN 50; Tensioni : 3~400 V, 50 Hz; Fuqia elektrike : 1.5 kË; Rryma elektrike : 7.7 A	copë	2		
373	Pj	Ventilator Centrifugal; Prurja 1400 m3/h, Presioni Statik =150 Pa -Fuqia 360 Ë -Dimensionet AxBxH = 560x560x460	copë	2		
374	Pj	F. POMPA E IMPIANTIT TE MBROJTJES NGA ZJARRIT - SISTEMI I MNZ-se; Grupi i MNZ sipas EN12845 i perbere nga 2 Pompa njera Elektrike dhe tjetra Diesel 2x15kË (1 ne pune + 1 ne stand-by) ku secila jep Q= 40 m ³ /h; H=60 mkH2O; Pompe Pilot "Jockey" 1x0.65 kË, Grupi i MNZ kompletuar me Kit Testimi me mates	copë	1		
375	Pj	Hidrant zjarri i jashtem kollone mbi toke DN 80 me dy dalje DN70	copë	3		
376	Pj	F.Kasetë jashte murit me kembeze, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 - UNI 10799. Dimensionet (370x610x190) mm, tub fleksibël 30 m, Aksesorët: saraqineske ndërprerëse 2½", lançë + zorre uji DN 70. Pjesa e përparme e mbyllur me çelës. (Qendron ne krah te hidrantit te jashtem)	copë	3		
		F. Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 -				

377	Pj	UNI 9227, me baze rezine. Dimensionet (370x610x190) mm, tub fleksibël 30 m, Aksesorët: saraqineske ndeërprerëse 1½", lançë + zorre uji DN 45. Pjesa e përparme e mbyllur me çelës.	copë	6		
378	Pj	F. Fikëse zjarr me pluhur, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A-233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartesia 640 mm.	copë	13		
379	Pj	F. Fikëse zjarr me CO2, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertesa. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 113B, kapaciteti normal 5 kg, pesha 14.1 kg. Diametri 152mm, lartesia 750 mm.	copë	6		
380	Pj	F. Grupi i lidhjes me motopompen e zjarrefikeses per hidrant DN 80. Vendosi në kasetë të jashtme, llamarine çeliku të emaluar ne ngjyre, te kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 3" (DN 80) materiali i grupit bronzo.	copë	1		
381	Pj	F. Pajisje tip Dysheme/Tavan , kapaciteti ne ftohje / ngrohje 8.0 /9.0 kË, prurja e ajrit Vmax.= 1250 m³/h + termostat ambient.	copë	2		
382	Pj	F. Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.2/2.5 kË, prurja e ajrit Vmax.= 400 m³/h + termostat ambient.	copë	1		
383	Pj	F. Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 4.5 /5.0 kË, prurja e ajrit Vmax.=750 m³/h + termostat ambient.	copë	2		
384	Pj	F. Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 6.3/7.1 kË, prurja e ajrit Vmax.=1150 m³/h + termostat ambient.	copë	8		
385	Pj	F. Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.1/8.0 kË, prurja e ajrit Vmax.=1150 m³/h + termostat ambient.	copë	3		
386	Pj	F. Pajisje tip Kasete me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 8.0/9.0 kË, prurja e ajrit Vmax.=1250 m³/h + termostat ambient.	copë	1		
387	Pj	F. Pajisje tip Kanalor me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 5.6 6.3 kË, prurja e ajrit Vmax.= 1000 m³/h + termostat ambient.	copë	10		
388	Pj	F. Pajisje tip Kanalor me pompe kondense, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 7.1 /8.0 kË, prurja e ajrit Vmax.= 1250 m³/h + termostat ambient.	copë	21		
389	Pj	Pulte kontrolli Touch Panel	copë	24		
390	Pj	Pulte kontrolli qendror (Touch Panel)	copë	3		
391	Pj	F. NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER KATIN +1 dhe -1 °; Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1/36°C :84 / 94.5 kË; Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 26.2 kË, 400V / 3 F ~ 50Hz . Pesha = 700 kg, me permasa AxBxC: (2x940) x 1340 x 1740 mm.Gazi ftohes R410A	copë	2		
392	Pj	F. NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER KATIN 0° Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1/36°C :123 / 138 kË . Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 38 kË, 400V / 3 F ~ 50Hz . Pesha = 800 kg, me permasa AxBxC: (2x940) x 1340 x 1740 mm.Gazi ftohes R410A	copë	1		
393	Pj	F. NJESI E JASHTEME KOMPRESOR INVERTER ME POMPE NXEHTESIE VRF PER RIKUPERATORET E AJRIT Kapaciteti ftohes / ngrohes ne temperaturen -1/36°C :56 / 63 kË . Fuqia elektrike / tensioni /ushqimi : 16.2 kË, 400V / 3 F ~ 50Hz . Pesha = 400 kg, me permasa AxBxC: (2x765) x 1340 x 1740 mm.Gazi ftohes R410A	copë	1		
394	Pj	F. NJESI RIKUPERATORE AJRI; Volumi i ajrit. 3920 m³/h ; Presioni statik i jashtem 200 Pa; Fel.ventilatoreve 2x0.9 kË 1F~230V,50Hz; Kap.Termik ne Ndrohje 40 kË ;Kap.Rekuperimi Ndrohje 57%; Kap.Rekuperimi Ftohje 50% Dimensionet A,B,C: 600x235x2050 mm; Pesha 400 kg	copë	2		
		F. Kondicioner Mono Split Dysheme – Tavan; Kapaciteti në				

395	Pj	ftohje: 12.1 kË; Kapaciteti në ngrohje: 13.1 kË; Fuqia elektrike në ftohje: 3.8 kË; Klasi A+++ / Gas frigoriferik R32 /; Dimesionet AxBxC: 914 x 970 x 370 mm	copë	3		
396	Pj	F. Kondicioner Mono Split DysHEME – Tavan; Kapaciteti në ftohje: 2.5 kË; Kapaciteti në ngrohje: 2.8 kË; Fuqia elektrike në ftohje: 0.7 kË; Klasi A+++ / Gas frigoriferik R32 /; Dimesionet AxBxC: 914 x 970 x 370 mm	copë	2		
397	Pj	F. Ventilator Centrifugal; V.air. 16000 m ³ /h ~ ΔP 200 Pa; Fel. 2.2 kË 3F~400V,50Hz; Nr. rrotullimeve: 473 r/min Nivelu zhurmes = 78dB (A); Dimensionet: 1400x1200x1200 cm; Ëeicht: 200 kg	copë	1		
398	Pj	F. Ventilator Centrifugal; V.air. 22000 m ³ /h ~ ΔP 400Pa; Fel. 5.5 kË 3F~400V,50Hz; Nr. rrotullimeve: 509 r/min; Nivelu zhurmes = 78dB (A); Dimensionet: 1700x1500x1500 cm; Peshë 450 kg	copë	1		
399	Pj	Ndrices katrore LED 40Ë, 4000K me kase të pershtatshme për montim jashtë murit ose në gips 60x60cm	copë	189		
400	Pj	Ndrices led 60x60, 36Ë, 3400lm, 4000K, me kase të pershtatshme për montim jashtë murit ose në gips 60x60cm	copë	91		
401	Pj	Spot tualeti, 220V, IP65, 10-12Ë max 4000 K	copë	31		
402	Pj	Spot tavanor inkaso 18Ë 4000K, 220V 1500-1600 lm	copë	7		
403	Pj	Spot tavanor inkaso 18Ë 4000K, 220V 1020-1100 lm IP65	copë	2		
404	Pj	Prozhektor LED 70Ë IP 65, 4000 K	copë	17		
405	Pj	Ndrices tip High By 20Ë 4000 K	copë	8		
406	Pj	Ndrices 28Ë LED 220V 4000 K instalim jashtë murit	copë	12		
407	Pj	Ashensore (3 ndalesa/ dyer inoxi/ kabina inox forest, kendet inoxi) 630 kg Kapaciteti 8 Persona,	copë	1		
		SHUMA 26:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						
						0.00

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “*DAJTI PARK 2007*” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Licencë LN-3338-06-2017, datë 02.06.2017 Kodi III.2.B, emërtimi përshkruar i veprimtarisë “Grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve urbane”.

III.1.4. Në nenin 2 “*Qëllimi*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 21 pika 1 “*Autoriteti ose enti kontraktor*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.6. Në nenin 77 “*Kërkesat për kualifikim*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose

entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.7. Në nenin 39 pika 6 germa a) “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

III.1.8. Në seksionin “Kategoria III.2. “ Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis ” , nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se:“ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

III.1.9. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”. Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.1.10. Në shtojcën 1, pika 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 402, Datë 30.06.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, përcaktohet: “17 Mbetje Nga Ndërtimet Dhe Prishjet (Përfshi Dhera Të Gërmuara Nga Zona Të Kontaminuara)”.

17 01 Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika

17 01 01 Beton

17 01 02 Tulla

17 01 03 Tjegulla dhe qeramika

17 01 06* Përzierje ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegulla dhe qeramikës që përmbajnë substance të rrezikshme

17 01 07 Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06

17 02 Dru, qelqe dhe plastika

17 02 01 Dru

17 02 02 Qelqe

17 02 03 Plastikë

17 02 04* Dru, qelq dhe plastika që përmbajnë substancë të rrezikshme

17 03 Përzierje bituminoze, bitumi dhe produkte të tjera të ziftit

17 03 01* Përzierje bituminoze që përmbajnë zifte qymyri

17 03 02 Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01

17 03 03* Zifte qymyri dhe katrane

17 04 Metale (përfshi dhe aliazhet e metaleve)

17 04 01 Bakër, bronx, tunxh

17 04 02 Alumin

17 04 03 Alumb

17 04 04 Zink

17 04 05 Hekur dhe çelik

17 04 06	<i>Kallaj</i>
17 04 07	<i>Metale të përziëra</i>
17 04 09*	<i>Mbetje metalore të kontaminuara me substanca të rrezikshme</i>
17 04 10*	<i>Kablllo që përmbajnë naftë, bitum apo substanca të tjera të rrezikshme</i>
17 04 11	<i>Kablllo të tjera nga ato të përmendura në 17 04 10</i>
17 05	<i>Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera)</i>
17 05 03*	<i>Dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme</i>
17 05 04	<i>Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03</i>
17 05 05*	<i>Balta që përmbajnë lëndë të rrezikshme</i>
17 05 06	<i>Balta, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 05</i>
17 05 07*	<i>Çakëll që përmban substanca të rrezikshme</i>
17 05 08	<i>Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07</i>
17 06	<i>Materiale izoluese dhe materiale ndërtimi me azbest</i>
17 06 01*	<i>Material izolimi që përmban azbest</i>
17 06 03*	<i>Material izolimi që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme</i>
17 06 04	<i>Materiale izolimi të tjera nga ato të përmendura në 17 06 01 dhe 17 06 03</i>
17 06 05*	<i>Materiale ndërtimi që përmbajnë asbest</i>
17 08	<i>Materiale ndërtimi me gips</i>
17 08 01	<i>Materiale ndërtimi me gips që janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme</i>
17 08 02	<i>Materiale ndërtimi me gips, të tjera nga ato të përmendura në 17 08 01</i>
17 09	<i>Mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve</i>
17 09 01*	<i>Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë merkur</i>
17 09 02*	<i>Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë PCB</i>
17 09 03*	<i>Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziëra që përmbajnë substanca të rrezikshme</i>
17 09 04	<i>Mbetje të përziëra nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.</i>

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "DAJTI PARK 2007" SHPK, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin -

Licencë LN-3338-06-2017, datë 02.06.2017 Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve urbane”, për vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterit të vecantë të kualifikimit pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik në shtojcën 7. Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “OE ka paraqitur licensë të lëshuar nga QKB me kodin III.2.B me veprimtari: “Grumbullim, ruajtje dhe transport i mbetjeve urbane” me të ndrejtën për të administruar mbetje jo të rrezikshme sipas shtojcës 1 në të cilën përfshihen nënkategori të kodit 20 (mbetje urbane). Kjo licensë nuk perputhet me licensën e kërkuar AK ku veprimtaria duhet të jetë Grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta e cila përfshin kodin 17 (Mbetje nga ndërtimet)”, Komisioni Prokurimit Publik gjykon se, përcaktimi i autoritetit kontraktor, se operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin Licensë me Kodin III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta”, është një kërkesë e drejtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës zërat e punimeve të parashikuar në preventive, si dhe me legjislacionin e fushës përkatëse konkretisht në Vendimin Nr. 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve” Tipat e mbetjeve në katalog” pika 17 në të cilën përcaktohet se “17 Mbetje Nga Ndërtimet Dhe Prishjet (Përfshi Dhera Të Gërmuara Nga Zona Të Kontaminuara)”. Ndërkohë që referuar preventivit në shtojcën 2 konstatohet se, zërat e punimeve janë zëra ndërtimi, konkretisht punime prishje, punime ndërtimi, punime shtresash, punime muresh, suvash etj, nga veprimtaria e të cilave lindin mbetje jo urbane por mbetje inertesh të cilat sipas VKM Nr. 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, ato kategorizohen në pikën 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshin dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)”. Në këtë kontekst përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor të një kriteri i cili lidhet plotësisht me objektin e kontratës dhe që i shërben realizimit të kontratës, sjell si pasojë qartësi dhe përcaktim të dokumentit konkret tek operatorët ekonomik, në lidhje me mënyrën mënyrën e plotësimit të këtij kriteri nga ana e tyre, por dhe të komisionit vlerësimit të ofertave duke bërë kështu totalisht të qartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret kriteri i mësipërm e ka vendosur në kushte të barabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik nëse do të referohemi shtojcës 2 të DST në të cilën parashikohen zërat e punimeve, pra operatorët do të duhet të paraqesin Licensë III.2.B “Grumbullim, rruajtje dhe transport i mbetjeve urbane”, apo Licensë III.2.B “Grumbullim, transport i mbetjeve nga ndërtimi dhe prishjet”, e cila sipas VKM 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, pika 17 përfshin mbetjet që do të krijohen nga zërat e parashikuar të punimeve në shtojcën 2 të DST. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi i kriterit në pikën 2.3.3 është në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës, zërat e parashikuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 2 të dokumentave standarte të tenderit, e rrjedhimisht në përputhje dhe me dispozitat ligjore të sipërcituara.

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e

përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur. Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK me dokumentacionin e paraqitur nuk provon se është i pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, duke moplotesuar kështu kërkesën për kualifikim, për pajisjen me licensën e kërkuar sipas pikës 2.3.3. Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK nuk ka dorëzuar licensën e kërkuar përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, kërkesë kjo e cila nuk është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik “DAJTI PARK 2007” SHPK.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “DAJTI PARK 2007” SHPK nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “DAJTI PARK 2007” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “LIS KONSTRUKSION” shpk & “S I R E T A 2F shpk si dhe BOE NIKA shpk & MANE/S shpk, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar,

Komisioni sqaron se, në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues “DAJTI PARK 2007” SHPK edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik ankimues që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur - Punë” **REF- 21199-09-23-2024**, me objekt: “Ndërtimi i Qendrës Multifunkionale Kampusi Rinor pranë DROFPP nr.4 Tiranë” me fond limit 222,179,998.30 (dyqind e njëzet e dy milion e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë presje tridhjetë), zhvilluar më datë 09.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Dajti Park 2007” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

